



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/09

Datë: 13.03.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 41 të Ligjit Nr. 02/L-109 për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse, Ligjit nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetror, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 mars 2020, nxjerr këtë:


V E N D I M

Për marrjen e masave shtesë pas konfirmimit të rasteve pozitive me Corona Virus COVID-19

1. Ndalohen hyrje-daljet e qytetarëve në Komunën e Klinës;
2. Ndalohen hyrje-daljet e qytetarëve në Komunën e Vitisë;
3. Ndërpritet me efekt të menjëhershëm transporti ndër-urban në Republikën e Kosovës, si dhe transporti i organizuar ndërkombëtar;
4. Mbyllet kufijtë tokësor për udhëtarët që hyjnë në Kosovë, kjo nuk vlen për qytetarët kosovarë, të gjithë shtetasit e Kosovës të cilët hyjnë përmes këtyre kufijve do t'u nënshtrohen kontrolleve të shtuara mjekësore me urdhrin që ata të vet izolohen për 14 ditë;
5. Nga data 16 mars 2020 ora 24:00, bëhet pezullimi i përkohshëm i të gjitha linjave të udhëtimit ajror në aeroportin e Prishtinës përveç fluturimeve ushtarake, dhe emergjencave medicinale (MEDIVAC). Përjashtim bëjnë linjat e udhëtimit në ardhje me ekuipazh por pa udhëtarë që shërbejnë vetëm për largim të udhëtarëve nga Kosova;
6. Mbyllet kafeteritë, baret, pabet dhe restorantet, qendrat tregtare me përjashtim të farmacive dhe marketeve ushqimore;
7. Pezullohen të gjitha aktivitetet kulturore dhe sportive;
8. Mbyllet tregjet e kafshëve dhe tregjet e automjeteve;
9. Reduktohen në veprimet esenciale dhe staf esencial për çdo institucion publik përveç stafit të sektorit të shëndetësisë dhe të sektorit të sigurisë;
10. Urdhërohen kompanitë private që ta organizojnë punën në atë mënyrë që shumicën e aktiviteteve punëtorët t'i kryejnë nga shtëpia;

11. Rekomandim: U bëhet thirrje të gjithë qytetarëve që t'u shmangen ambienteve të frekuentuara me njerëz dhe t'u përmbahen të gjitha masave të ndërmarra nga Qeveria dhe rekomandimet e dhëna nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës;
12. Obligohet Ministria e Shëndetësisë dhe Institucionet tjera relevante, të kryejnë të gjitha procedurat për zbatimin e këtij Vendimi;
13. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/09
Datë: 13.03.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 mars 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë Nr. 01/08, i datës 12 mars 2020, pas pikës 1.22. shtohen edhe anëtarët si në vijim:
 - 1.23 Lumir Abdixhiku, Ministër i Infrastrukturës dhe Ambientit, anëtar;
 - 1.24 Naser Ramadani, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës, anëtar;
 - 1.25 Përfaqësues nga Klinika Infektive në SHSKUK, anëtar;
 - 1.26 Përfaqësues nga Qendra e Situatave në Sekretariatit e KSK, anëtar.

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë